

## **Deklaratë për ndryshime të Ligjit për Donacione dhe Sponzorime në Veprimtaritë publike**

*Nevojitet ligj i cili me të vërtetë do ta nxisë donimin  
**Procesi i ndryshimeve duhet të vazhdojë me patjetër!***

Ne, përfaqësuesit e sektorit qytetar dhe organizatave dhe institucioneve të tjera (me rol të marrësve të donacioneve dhe sponzorimeve) dhe bashkësisë të biznesit (në rolin e dhënësve të donacioneve dhe sponzorimeve) kemi qëndrime të njëjta mbi nevojën e ndryshimeve të Ligjit për Donacione dhe Sponzorime në Veprimtaritë Publike. Ky ligj ndikon në zhvillimin e kulturës, arsimit, mbrojtjes sociale, mjedisit jetësor, sportit dhe fushave tona të tjera me interes publik në të cilat përveç shtetit investojnë edhe ndërmarrjet dhe qytetarët. Por, **Ligji nuk u shërben në tërësi atyre për të cilët është miratuar dhe nuk e plotëson si duhet funksionin e vet.**

Përkufizimet e paqarta dhe numri i madh i obligimeve e vështirësojnë punën e institucioneve dhe krijojnë shpenzime. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe qytetarët pothuajse nuk e shfrytëzojnë aspak Ligjin për shkak të procedurës së komplikuar për shfrytëzim të nxitjeve tatimore. Beneficionet tatimore, sidomos tek tatimi personal i të ardhurave në praktikë nuk funksionojnë.

Sistemi i nxitjeve tatimore duhet të ndryshojë. Kështu, zgjidhja e re ligjore duhet të çojë në zmadhimin e niveleve të donacioneve dhe sponzorimeve duke i motivuar dhënësit, në vend që të tërhiqen prej shfrytëzimit të Ligjit. Dhënia e zmadhuar, do të thotë mbështetje e një numri të madh aktiviteteve të dobishme publikisht. Shtesë, ndërtimi i besimit në konceptin e dhënies së donacionit do ta zmadhonte mundësinë e subjekteve joprofitabile të cilat veprojnë dhe ndërmarrin aktivitete në interes të bashkësisë, të mbështeten në resurset lokale në vend të donatorëve të huaj të cilët po tërhiqen.

E përshëndesim procesin demokratik pjesëmarrës të zbatuar deri më tani në ndryshimin e Ligjit. Në 4 vitet e kaluara, aktivisht morëm pjesë në diskutimin mbikëqyrës për implementim të Ligjit, në debatet publike, forumet dhe hulumtimet. Qëndrimet tona janë përcjellë te grupi ndërsektorial i punës për përgatitje të ndryshimeve të Ligjit i formuar nga Ministria kompetente, Ministria e Drejtësisë. Në periudhën shkurt-maj 2012, grupi i punës ka mbajtur takime të rregullta në të cilat u përgatit versioni i parë i punës i ndryshimeve të Ligjit. Prej atëherë grupi i punës nuk është mbledhur dhe **procesi i ndryshimeve stagnon**. Mungojnë informacionet për arsye për shkak të të cilave procesi ka ndaluar. Të shqetësuar për këtë gjendje ku donatorët nuk i shfrytëzojnë fitimet e parashikuara me Ligj, për shkak të paqartësive dhe procedurave të dhëna jo qartë dhe konstatojmë se duhet:

- Të riaktivizohet procesi i ndryshimeve të Ligjit për Donacione dhe Sponzorime në Veprimtaritë Publike me konsultime të vazhduara me palët e prekura duke përfshirë edhe pjesëmarrje të organizatave qytetare në grupin ndërsektorial të punës për përgatitje të ndryshimeve të Ligjit, me qëllim që zgjidhja e re të përputhet me nevojat e shfrytëzuesve të tij;
- Ndryshimet e Ligjit të jenë në përputhje me [përfundimet](#) e miratuara të Komisionit për Kulturë në Kuvendin e RM-së pas mbajtjes të diskutimit mbikëqyrës për ndjekje të implementimit të Ligjit në vitin 2010, pastaj me [“Analizën e zbatimit të Ligjit për Donacionet dhe Sponzorimet në veprimtaritë publike 2007-2011”](#) Rezymeja e të cilës është bashkangjitur, si dhe me praktikatat dhe politikat praktike të vendeve anëtare të BE-së në lidhje me procedurat për realizimin dhe kontrollin e lehtësimeve tatimore;

Jemi të përgatitur për bashkëpunim me angazhim të vazhdojmë të jemi partner konstruktiv në procesin e ndryshimeve të Ligjit. Në këtë drejtim jemi në dispozicion të institucioneve dhe grupit ndërsektorial të punës për konsultime shtesë.

Shkup

Qershor 2013

Në vijim:

- Lista e nënshkrimeve
- Rezymeja e Analizës së Zbatimit të Ligjit për Donacionet dhe Sponzorimet në Veprimtaritë Publike 2007-2011
- Përfundimet e Komisionit të Kulturës në Kuvendin e RM-së pas mbajtjes së diskutimit mbikëqyrës për ndjekje të implementimit të Ligjit për Donacionet dhe Sponzorimet në Veprimtaritë Publike

Dorëzuar në:

- Kuvendin e RM-së
- Ministrinë e Drejtësisë
- Ministrinë e Financave

Kopje dorëzuar te:

- Zëvendëskryeministri i Qeverisë i obliguar për çështje ekonomike
- Sekretariati për Çështje Evropiane
- Ministria e Ekonomisë
- Ministria e Kulturës
- Drejtoria e të Hyrave Publike